

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7173
E premte, 26 prill 2024
Çmimi 0.50 €

A do të vendosin shqiptarët për presidentin e Maqedonisë së Veriut më 8 maj?



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

A E KA ASOCIACIONI ÇELËSIN E KËSHILLIT TË EVROPËS?

FAQE 4-5



Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe - një thirrje e kamotshme e bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën - duket se po shndërrohet tani në një lloj kushti

për të për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës. Pas marrjes së dritës së gjelbër në Asambenë Parlamentare të KiE-së më 16 prill, vendimin përfundimtar për Kosovën pritet

ta sjellë Komiteti i Ministrave i kësaj organizate më 16 maj. Deri atëherë Kosova duhet të vazhdojë t'i bindë së paku dy të tretat e 46 anëtarëve të saj përse duhet të jetë në mesin e tyre.

SYLEJMAN SELIMI DHE JAHIR DEMAKU LIROHEN NGA AKUZA PËR KRIME LUFTE

F.7



KURTI TAKON MËRGATËN NË GJERMANI: REGJISTROHUNI, VOTONI DHE INVESTONI NË KOSOVË

F.7

AKTUALE



SËRISH S'KA KUORUM PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

F.3

PSD-ja, AKSION PARA QEVERISË, "PËRURON" ÇEZMËN E MILIONERËVE

F.3

HARADINAJ: FADIL VATA DO TË MBETET GJITHMONË SHEMBULL FRYMËZUES PËR PËRKUSHTIMIN NDAJ ATDHEUT

F.6

EKONOMI



TË HYRA MBI 500 MILIONË EURO, DOGANA SHËNON REKORD TË RI

F.8

10 MIJË VIZITORË E VIZITUAN PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË TURIZMIT NË PRISHTINË

F.8

SPORT



KATËR KLUBE NDJEKIN KUPËN NË HENDBOLL

F.12

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

A do të vendosin shqiptarët për presidentin e Maqedonisë së Veriut më 8 maj?

SHKUP, 25 PRILL - Kandidatja opozitare Gordana Silanovska-Davkova e ka fituar bindshëm raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale në Maqedoninë e Veriut të mërkurën dhe do të përballlet me presidentin aktual, Stevo Pendarovski, në raundin e dytë në muajin e ardhshëm.

Por, me gjithë fitoren bindëse të Davkovës në raundin e parë, votat e shqiptarëve mund përsëri të luajnë rol kyç në raundin e dytë sikurse para pesë vjetëve.

Sipas Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), Davkova - e cila vjen nga partia opozitare VMRO DPMNE, i fitoi 40.10 për qind të votave, ndërsa Pendarovski nga Lidhja Social Demokrate (LSDM) në pushtet, i fitoi 19.93 për qind të votave.

Shtatë kandidatë garuan në raundin e parë, në mesin e të cilëve edhe dy shqiptarë, të cilët nuk ia dolën të fitonin vota të mjaftueshme për ta siguruar balotazhin.

Bujar Osmani nga Fronti Evropian i mori 13.36 për qind të votave, ndërsa Arben Taravari nga koalicioni opozitar VLEN 9.21 për

qind të votave.

Davkova, pasi e fitoi raundin e parë, tha se nuk është kundër integritimit evropian të vendit, por se kërkon që integrimi “të mos bëhet duke dëmtuar interesat shtetërore e kombëtare maqedonase”. Ajo u zotua se, nëse zgjidhet presidente, do të angazhohet për thellimin e bashkëpunimit rajonal, “që vendet e rajonit së bashku të ecin drejt rrugës së integritimit në Bashkim Evropian”.

Kandidati i LSDM-së, Stevo Pendarovski, u zotua se do ta vazhdojë betejën në raundin e dytë të zgjedhjeve “për një fitore dhe për realizimin e agjendës evropiane” të Maqedonisë së Veriut. “Koncepti im është të jetojmë në një shteti të integruar në BE dhe jo të izoluar. Në një shtet ku nuk do të ketë ndarje dhe i cili do të jetë pjesë e integritimit euroatlantik”, tha Pendarovski.

Sipas KSHZ-së, rreth 49 për qind e 1.8 milion shtetasve më të drejtë vote e hodhën votën në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale të mërkurën.

Fitorja e thellë e kandidatës



opozitare Davkova ishte parashikuar pothuajse në të gjitha hulumtimet e opinionit publik. Zgjedhjet presidenciale të 24 prillit shihen si test i rëndësishëm për partitë politike, pasi ato u mbajtën pak javë para zgjedhjeve parlamentare të majit.

Sipas vlerësimeve të njohësve të çështjeve politike, VMRO DPMNE është pranë fitores së dyfishtë më 8 maj, Presidencës dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut.

VMRO DPMNE-ja është një parti konservatore maqedonase me ideologji demokristiane, e cila ka



kundërshtuar Marrëveshjen e Prespës me Greqinë për ndryshimin e emrit Maqedoni në Maqedoni të Veriut, pavarësisht se ky ishte kusht për anëtarësimin e këtij vendi në NATO.

Davkova dhe Pendarovski do të përballen në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të cilat do të mbahen më 8 maj, së bashku me zgjedhjet parlamentare.

Davkova ishte kandidatë për presidente edhe në zgjedhjet e vitit 2019, por humbi në raundin e dytë përballë Pendarovskit, i cili triumfoi falë votave të shqiptarëve

të cilët i ndihmuan ta përmbyste epërsinë e Davkovës nga raundi i parë i zgjedhjeve.

Se a do të ketë përmbysje të rezultatit edhe më 8 maj mbetet të shihet, por bazuar në dallimin e thellë të Davkovës prej rreth 180 mijë votave, Pendarovskit i nevojitet mbështetja e dy kandidatët shqiptarë për president, Bujar Osmanit dhe Arben Taravari, që së bashku kanë siguruar rreth 200 mijë vota.

I pyetur se cilin kandidat do ta mbështesë më 8 maj, Taravari u përgjigj: “Ende nuk kemi vendosur. Si koalicion duhet të ulemi dhe të bisedojmë për këtë çështje”.

Por, ai ka marrë një mesazh nga kryetari i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickoski, i cili e ka uruar për rezultatin e arritur në zgjedhje dhe i ka shprehur gatishmërinë për të biseduar për pjesëmarrjen e opozitës shqiptare në qeverinë e ardhshme pas 8 majit. Kandidati i Frontit Evropian, Bujar Osmani, gjithashtu nuk është prononcuar se cilin nga kandidatët do ta mbështesë në raundin e dytë, por ka përsëritur thirrjen për unitet në rrugën e integritimit evropian. (rel)

Anulohen mijëra fluturime për shkak të grevës të kontrollorëve ajrorë në Francë



PARIS, 25 PRILL - Mijëra fluturime në Francë dhe Evropë u anuluan më 25 prill për shkak të grevës të kontrollorëve të trafikut ajror në Francë.

Greva ka shkaktuar ndalesën më të madhe në trafikun ajror në dekada.

Kompanitë e fluturimeve kanë përgjysmuar fluturimet në dy aeroportet kryesore në Paris, në Orly dhe Roissy Charles-de-Gaulle. Në Marsej, po ashtu, janë anuluar shumë fluturime.

Më të prekurat janë fluturimet me destinacione të shkurtra, por edhe fluturimet e gjata janë përballur me pengesa.

Ryanair ka raportuar se ka anuluar 300 fluturime më 25 prill, ndërkaq Easyjet dhe Transavia nga 200 secili. Në total, rreth 2 300 fluturime në aeroportet franceze pritet të realizohen të enjten, për dallim nga 5 200 sa ishin realizuar një ditë më parë, tha autoriteti i aviacionit civil, DGAC.

Në mbarë Evropën, rreth 2 000 fluturime të tjera janë anuluar dhe rreth 1 000 të tjera kanë ndryshuar rrugën për ta shmangur hapësirën ajrore franceze.

Numri i fluturimeve të anuluar ishte më i larti “në 20 vjet”, sipas Augustin de Romanet, drejtor i Grupit ADP, që menaxhon

aeroportet në kryeqytetin francez. Ai paralajmëroi se “dhjetëra mijëra dollarë” po trezikohen nga anulimi i fluturimeve për shkak të grevës.

Shoqata e trafikut ajror, IATA, akuzoi kontrollorët francezë se po “shantazhojnë” dhe po bëjnë kërkesa të përealizueshme.

Greva e kontrollorëve ajrorë vazhdoi pavarësisht se një shoqatë e madhe e punëtorëve të trafikut ajror u tërhoq nga greva më 25 prill për shkak se tha se do t'i vazhonte negociatat me autoritetet shtetërore lidhur me kushtet e punës.

Megjithatë, në grevë janë edhe tri shoqata të tjera.

Zelensky kërkon ashpërsimin e sanksioneve ndaj Rusisë

KIEV, 25 PRILL - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky bëri thirrje për zgjerimin e sanksioneve ndërkombëtare kundër Rusisë për shkak të pushtimit të paprovokuar që Moskë nisi ndaj shtetit të tij më 2022.

Zelensky e bëri këtë thirrje më 25 prill, teksa u takua në Kiev me ministrin britanik të Financave, Jeremy Hunt, me të cilin bisedoi për situatën në Ukrainë dhe nevojën për ta bërë më të vështirë që të shmangen sanksionet e vendosura ndaj Rusisë. “Ne i kushtuam rëndësi të veçantë politikës së sanksioneve. Është e rëndësishme të zgjerohen masat kufizuese kundër Rusisë dhe që shmangia e

sanksioneve të jetë e pamundur”, shkroi Zelensky në “X”.

Zelensky falënderoi Britaninë për paketën e re të ndihmës ushtarake të cilën e paraqiti më herët gjatë javës kryeministri britanik Rishi Sunak.

Paketa në vlerë prej 622 milionë dollarësh - më e madhja që Britania deri më tani i ka dhuruar Ukrainës - u bë publike nga Sunaku gjatë vizitës që ai zhvilloi në Poloni më 23 prill, duke bërë që ndihma e përgjithshme ushtarake që Londra i ka premtuar Kievit gjatë këtij viti të arrijë në 3.71 miliardë dollarë.

Britania, një prej aleateve kyçe të Ukrainës, po ashtu, tha se do të dërgojë në Kiev paketën më të

madhe ushtarake.

Ministri britanik Hunt gjatë vizitës në Ukrainë u takua edhe me kryeministrin ukrainas Denys Shmyhal me të cilin bisedoi për përmbajtjen e paketës së ndihmës ushtarake e cila përfshin sisteme të mbrojtjes ajrore në mënyrë që Ukraina t'i mbrojë më mirë qytetet nga sulmet ajrore ruse.

Vizita e Huntit në Ukrainë vjen pak pasi presidenti amerikan Joe Biden më 24 prill nënshkroi paketën e ndihmës ushtarake për Kiev në vlerë prej 61 miliardë dollarësh. Sipas presidentit amerikan, ndihma e nevojshme, përfshirë sisteme të mbrojtjes ajrore, do të dërgohet brenda orësh.



Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku lirohen nga akuza për krime lufte

PRISHTINË, 25 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim lirues ndaj ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi dhe ish-pjesëtarit të UÇK-së, Jahir Demaku, të cilët akuzoheshin për krime lufte kundër popullatës civile.

Aktgjykimi ndaj Selimit dhe Demakut u shpall të enjten nga gjykatësi Ngadhjnim Armi. Sipas gjykatësit Armi, të akuzuarit lirohen nga akuza pasi nuk është vërtetuar se kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkoheshin nga PSRK-ja.

Po sipas aktgjykimit, trupi gjykyes ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit "A" dhe nga ajo nuk është vërtetuar se cili person i ka shkaktuar dëmtime personit që pretendohet se ishte ndaluar në Likovc.

Trupi gjykyes vlerësoi se dëshmia e dëshmitarit "A" si e vetme ka qenë e mangët për ta arritur standardin e të provuarit për krimet e luftës dhe vendimi është i bazuar në standardet vendore.

Fillimisht, Prokuroria Speciale kishte ngritur aktakuzë ndaj 15 të pandehurve, por që me aktvendim aktakuzë është ndarë në dy akuza, "Drenica 1", ku bëjnë pjesë Selimi dhe Demaku dhe "Drenica 2".

Gjykata Themelore në Mitrovicë në maj të vitit 2015 kishte shpallur fajtor dhe kishte dënuar me tetë vjet burg Sylejman Selimin për keqtrajtim të të ndaluarve në fshatin Likoc gjatë luftës. Bashkë me Selimin, Isni Thaçi dhe Jahir e Zeqir Demaku ishin dënuar me nga shtatë vjet burg, ndërsa me tri vjet burg ishte dënuar Nexhat Demaku.

Me nga tre vjet burgim ishin dënuar edhe Agim, Selman, Driton e Bashkim Demaj dhe Fadil Demaku.

Në shtator të vitit 2016 Gjykata e Apelit, duke vendosur lidhur me ankesat e të akuzuarve, kishte nxjerrë aktgjykim, duke vërtetuar në masë të madhe dënimet e shqiptuara nga gjykata në Mitrovicë.

Mirëpo, Gjykata e Apelit ia kishte



zbutur dënimin me një vit burg Sylejman Selimit.

Gjykata Supreme në korrik të 2017-s kishte refuzuar kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nga ana e të dënuarve, mirëpo Gjykata Kushtetuese në qershor të 2018-s e kishte kthyer rastin në rishqyrtim

Gjykatës Supreme.

E Gjykata Supreme sërish kishte vendosur t'i refuzonte kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga ana mbrojtësve të të dënuarve.

Sylejman Selimi akuzohej për pikën 6 të aktakuzës, kurse Jahir

Demaku për pikën 3 të aktakuzës, për veprën penale "Krime lufte kundër popullatës civile", që parashihet dhe dënohet me nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ (që momentalisht penalizohet me nenet 31 dhe 152 të KPRK). / BetimipërDrejtësi

Sërish s'ka kuorum për marrëveshjet ndërkombëtare

PRISHTINË, 25 PRILL - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) u ka bërë thirrje partive politike ta lëshojnë sallën të enjten derisa mbahej seanca plenare pas dështimit që të mbahet debat parlamentar për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

Deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, tha se partia në pushtet nuk i ka votat për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. "Po ju informoj që ne si LDK dhe po u bëjmë thirrje edhe partive politike opozitare, që duke e parë qasjen e kësaj mazhorance dhe duke votuar të trajtohet një dokument i rëndësishëm, siç ishte DASH-i, duke e parë, po ashtu, që as 30 deputetë nuk i keni për të



kaluar marrëveshje ndërkombëtare e që, në fakt, ministri (Hekuran Murati), na apostrofoi neve si fajtorë, që nuk është e vërtetë. Po harroni që sot

është dita e 304 që kemi sanksione dhe si e tillë i humbet rëndësia edhe e vet marrëveshjeve ndërkombëtare. Ne nuk duam të vazhdojmë të jemi pjesë e këtij

demolimi të parlamentarizmit dhe të jetës parlamentare këtu, andaj nga ky moment ne nuk qëndrojmë në sallë. U bëjmë thirrje edhe partive të tjera opozitare ta lëshojnë sallën dhe provoni reflektoni dhe t'i kthehemi normalitetit të jetës politike dhe institucionale në Kosovë", deklaroi Selmanaj.

Kryeparlamentari Glauk Konjufca tha se nuk mund të trajtohen marrëveshjet ndërkombëtare meqë nevojiten 80 deputetë të jenë të pranishëm dhe të votojnë. Ndërkaq shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, tha se opozita po bllokoi 300 milionë euro mjete nga marrëveshjet ndërkombëtare. "Me keqardhje më duhet të them se në

momentin kur deputeti Driton Selmanaj nga LDK-ja paralajmëroi largimin e deputetëve të këtij grupi parlamentar nga salla, vetëm tre deputetë nga 16 sa janë ishin në sallë. Ju lutem të jeni të hapur dhe të pranoni para qytetarëve të Kosovës dhe votuesve tuaj se nuk e kryeni këtë detyrë që e keni marrë, sepse dihet që për votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare duhen 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Prandaj, ikja nga përgjegjësia e deputetit, deputetes për votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, për zhbllokimin e 300 milionë eurove të bllokuara tash e gjashtë muaj në Kuvendin e Kosovës, duhet të jetë me të vërtetë një peshë e përgjegjësisë", u shpreh ajo. /kp/

PSD-ja, aksion para qeverisë, "përruron" çezmën e milionerëve

PRISHTINË, 25 PRILL - Partia e Dardan Molliqajit, PSD-ja, ka realizuar një aksion simbolik para ndërtesës së qeverisë. Zgjim Hyseni nga kjo parti para medieve tha se kjo që po e shihni këtu nuk është 'Kroi i fshatit tonë', i bukur e për të gjithë. "Kjo është çeshmja e milionerëve, sepse rrjedhë veç për ta. Në Kosovë, atyre që e shesin, iu falet uji. Këtë çeshme qysh e do zakoni e kanë sjell këtu kompanitë që përfituan miliona nga Liburn Aliu, si shenjë nderimi për të. Rreth 15 milionë e dimë se janë falur, por procesi ende nuk është zbardhur i tëri. Paramendoni, njëra nga kompanitë ka paguar 13 mijë euro për 12 vjet. Po e njëjta, veç për 6 muaj paguan 20 mijë euro. Këtu ka

potencialisht shkelje serioze ligjore. Vendimi administrativ nuk lejon parafaturë dhe pastaj procesi negocimi. Ai thjesht tregon si përlllogarit dhe faturohet shpenzimi i ujit", ka thënë Hyseni. Ai ka theksuar se këto biznese nuk janë biznese që iu duhet lëmoshë. "Po flitet për kompani milionëshe. Në Kosovë shkon te përmbartuesi për çdo gjë, KEDS-i të shkyçë nga rrjeti për 20 euro borxh, por borxhet e të mëdhenjve fshihen. Në mulli të kujt po çon ujë ky pushtet? Sikur krejt të tjerat, te bizneset e mëdha, mundësisht këto biznese të lidhen me ne. Ky është dallimi. Dallim i madh", është shprehur zyrtari i PSD-së, Zgjim Hyseni.





A e ka Asociacioni çelësin e Këshillit të Evropës?

PRISHTINË, 25 PRILL - Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe - një thirrje e kamotshme e bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën - duket se po shndërrohet tani në një lloj kushti për të për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës.

Pas marrjes së dritës së gjelbër në Asamblesë Parlamentare të KiE-së më 16 prill, vendimin përfundimtar për Kosovën pritet ta sjellë Komiteti i Ministrave i kësaj organizate më 16 maj. Deri atëherë Kosova duhet të vazhdojë t'i bindë së paku dy të tretat e 46 anëtarëve të saj përse duhet të jetë në mesin e tyre.

Dhe hapa pozitivë në këtë drejtim duket se janë pikërisht ata që çojnë në formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha të martën se "në kontekstin e rrugës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës, Franca i kushton rëndësi përparimit të shpejtë dhe të pakthyeshëm të Kosovës drejt formimit të Asociacionit".

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, tha se Kosova duhet të bëjë hapa të prekshëm, që nënkuptojnë "dërgimin e draft-statutit të Asociacionit në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim", në mënyrë që t'i bindë qeveritë skeptike që të votojnë në favor të saj për anëtarësim në Këshillin e Evropës.

Themelimi i Asociacionit ka qenë vazhdimisht kërkesë edhe e vendeve të tjera të grupit QUINT

që, pos Francës e Gjermanisë, përfshijnë edhe ShBA-në, Mbretërinë e Bashkuar dhe Italinë.

"Radio Evropa e Lirë" e pyeti Qeverinë e Kosovës nëse planifikon ta dërgojë draft-statutin në Kushtetuese përpara datës 16 maj, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori përgjigje.

Më 17 prill zëvendësministri i Jashtëm i Kosovës, Kreshnik Ahmeti, tha se themelimi i Asociacionit nuk është parakusht për pranimin e Kosovës në KiE, por shtoi se ai është pjesë e listës së zotimeve në kuadër të raportit të raportueses për Kosovën në Këshillin e Evropës, Dora Bakoyyanis, të cilat Kosova i ka marrë përsipër t'i zbatojë pas anëtarësimit në KiE.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha në një intervistë për "Zërin e Amerikës", më 23 prill, se dërgimi i draft-statutit të Asociacionit në Gjykatën Kushtetuese është detyrë e Qeverisë së Kosovës.

Ndërsa njohësit e çështjeve politike dhe diplomatike në Kosovë pajtohen se vendi duhet të bëjë "hapa pozitivë" për të mos rrezikuar anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

Belgim Kamberi, nga Instituti për Politika Sociale "Musine Kokolari" në Prishtinë, thotë se kërkesa ose sugjerimi i partnerëve perëndimorë është i qartë: Qeveria e Kosovës duhet ta dekretojë draft-statutin për Asociacionin dhe ta dërgojë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. "Në rast se dërgohet

[në Gjykatën Kushtetuese], atëherë, faktikisht, mund të thuhet se është deblokuar procesi i themelimit të Asociacionit... Deri më tash ky proces është bllokuar nga perspektiva e vendimmarrjes politike", thotë Kamberi për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, praktika e deritashme ka treguar se ministrat e Jashtëm në Këshillin e Evropës, përgjithësisht, i mbështesin vendimet e Asamblesë Parlamentare. Por, në rastin e Kosovës, thotë ai, marrë parasysh pritjet që i kanë disa vende lidhur me themelimin e Asociacionit, votimi më 16 maj mund të mos jetë fare në agjendën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. "Që të mos duket se po votojnë kundër vendimit të Asamblesë Parlamentare, rrezikohet që të mos futet fare në rend dite si një e formë e refuzimit jo të drejtpërdrejtë", thotë Kamberi.

Valon Murtezaj, profesor i Diplomacisë në Universitetin IESEG në Paris, thotë se çdo hap që mund ta bëjë Qeveria e Kosovës në drejtim të themelimit të Asociacionit, duhet ta bashkërendojë me kërkesat e partnerëve kryesorë, nga të cilët pret përkrahjen për anëtarësim në Këshillin e Evropës. "Nëse këto janë pritje nga ata që do të votojnë - dhe qeveria e di më së miri se cilat janë pritjet - atëherë duhet vendosur në bazë të drejtpeshimit ndërmjet pritjeve dhe gjasave për sukses në votim", thotë Murtezaj për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, hap tjetër që mund të bëjë Kosova para takimit të ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës,

më 16 maj, është: dërgimi i garancive të qarta të vendet përkatëse se do të zbatohen të drejtat e komuniteteve joshumicë, si dhe i sinjaleve të qarta se do të avancohet i gjithë korpusi ligjor që ndërlidhet me të drejtat e njeriut. "Do të ishte e dhimbshme që Kosova ta humbiste anëtarësimin pas gjithë këtij rrugëtimi të suksesshëm deri sot", thotë Murtezaj.

Në një intervistë dhënë REL-it më 18 prill, Gerald Knaus, nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet, tha se këshillë e tij për Kosovën do të ishte "ta dërgonte draft-statutin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese" përpara votimit në maj.

Organizata e Knausit publikoi së voni një dokument për rrugën e Kosovës drejt Këshillit të Evropës. Kosova aplikoi për t'u anëtarësuar në këtë organizatë gati dy vjet më parë - më 12 maj 2022. Më 27 mars të këtij viti Komiteti për Politikë dhe Demokraci i Këshillit të Evropës miratoi raportin e raportueses për Kosovën, Bakoyyanis, e cila tha se vendi i ka plotësuar kushtet për t'u bërë anëtar me të drejta të plota i organizatës, ndërsa Asociacionin e konsideroi si çështje të brendshme të Kosovës.

Më pas, më 16 prill, raporti i Bakoyyanisit kaloi edhe në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ndërsa vendimin përfundimtar do ta marrë Komiteti i Ministrave një muaj më vonë.

I përbërë prej 46 shtetesh

anëtare, 27 prej të cilave anëtare të Bashkimit Evropian, Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut.

Serbia njoftoi së voni se ka ngritur një grup punues për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë, përkundër marrëveshjes që ajo ka me Kosovën, për të mos e kundërshtuar anëtarësimin e saj në organizatë ndërkombëtare.

Polemika rreth Asociacionit

Kosova dhe Serbia u pajtuan për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe qysh në vitin 2013. Megjithatë, qeveri të njëpasnjëshme të Kosovës refuzuan ta zbatojnë marrëveshjen, duke shprehur frikë se asociacioni i tillë njëzetnik mund të ndikojë në funksionalitetin e duhur të shtetit.

Pas trysnisë së vazhdueshme, diplomatët perëndimorë hartuan një draft-statut të këtij asociacioni, të cilin ua dorëzuan Kosovës dhe Serbisë në fund të vitit të kaluar.

Udhëheqësit e dy vendeve thanë fillimisht se e kanë pranuar në parim, por kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" më 19 mars, se nuk e ka pranuar.

Para se të bëhet ndonjë hap tjetër, draft-statuti duhet të dërgohet për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

O'Brien kërkon "përparim urgjent" për themelimin e Asociacionit

PRISHTINË, 25 PRILL - Ndhmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, i ka kërkuar Kosovës të bëjë "përparim urgjent" sa i përket themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Gjatë një takimi të zhvilluar në Gjermani me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, O'Brien tha që Kosova duhet të lëvizë drejt integritimit euroatlantik dhe t'i zbatojë zotimet që dalin nga dialogu për normalizimin e raporteve me Serbinë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet nga Uashingtoni. "ShBA-ja mbështet rrugën e Kosovës drejt integritimit euroatlantike. Për të lëvizur përpara na duhet zbatimi i zotimeve të dialogut që ndërmjetësohet nga BE-ja, përfshirë edhe përparimin urgjent sa i përket Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sot diskutova me kryeministrin Kurti për hapat pozitivë që janë të nevojshme", shkroi ai në "X".

Ndërkaq ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, që ishte i pranishëm në këtë takim, tha se ShBA-ja pret që



Kosova dhe Serbia "t'i përmbushin të gjitha obligimet" e dialogut të Brukselit.

Në kuadër të dialogut për

normalizimin e raporteve që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje më 2013 dhe më pas më 2015 për

themelimin e Asociacionit.

Më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës kishte thënë se Marrëveshja mbi parimet për themelimin e Asociacionit nuk

kishte në përputhje të plotë me Kushtetutën.

Po ashtu, themelimi i Asociacionit është përfshirë edhe në Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të raporteve që palët arritën vitin e kaluar.

BE-ja dhe ShBA-ja vazhdimisht i kanë bërë thirrje Kosovës ta themelojë Asociacionin. Vitin e kaluar bashkësia ndërkombëtare u paraqiti Kosovës dhe Serbisë një draft-statut për Asociacionin.

Palët fillimisht e pranuan draft-statutin, por ende nuk është ndërmarrë ndonjë hap drejt themelimit të tij.

Po ashtu, vitin e kaluar Kosova dhe Serbia u pajtuan për Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit. Kjo marrëveshje, sipas BE-së, ende nuk është zbatuar nga palët.

Marrëveshja prej 11 nenesh parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Kurti: Duam t'i bashkohemi NATO-s si një ombrellë sigurie për kontinentin tonë

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti dhe ambasadori i Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti, pati të enjten në mëngjes takim pune në Fondacionin Bertelsmann, me personalitete të rëndësishme e studiues, në mesin e tyre deputetin e Bundestagut gjerman nga radhët e socialdemokratëve, Frank Schwabe, drejtuesin e Iniciativës së Stabilitetit Evropian (ESI), Gerald Knaus dhe drejtoreshën ekzekutive të fondacionit, Daniela Schwarzer.

Duke rikujtuar historikun e viteve '90 dhe rrugëtimin e shumë shteteve drejt integritimit euroatlantik dhe zgjerimin e BE-së, NATO-s e Këshillit të Evropës, në fjalën e tij, kryeministri Kurti nënvizoi qëllimin për anëtarësim në këto organizata dhe rëndësinë historike e momentumin e marrëdhënieve të Kosovës



me Gjermaninë dhe shtetet demokratike evropiane. "Hapin e parë e bëmë në vitin 2008 kur Kosova shpalli pavarësinë dhe shumica e demokracive në Evropë na

njohën. Hapi i dytë ka të bëjë me bashkimin me institucionet që janë shtyllat e Evropës demokratike. Ne duam t'i bashkohemi NATO-s si një ombrellë sigurie për

kontinentin tonë. Duam t'i bashkohemi Bashkimit Evropian si projekti dhe procesi më i rëndësishëm i paqes dhe prosperitetit. Por, hapi i parë që duhet të bëjmë

tani është t'i bashkohemi klubit të parë të demokracive evropiane, i krijuar pikërisht në këtë muaj 75 vjet më parë në Londër: Këshilli i Evropës", tha kryeministri Kurti.

Ai shtoi se Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për respektimin e vlerave të përbashkëta, të të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë. Ai u bëri thirrje zyrtarëve të Gjermanisë të vijojnë ta mbështesin Kosovën edhe në fazën e fundit të votimit dhe arritjes së anëtarësimit të plotë në këtë organizatë.

Kryeministri Kurti u shpreh se pranimi i Kosovës si anëtare e 47 e Këshillit të Evropës në 75-vjetorin e saj këtë vit është një përparim historik për Kosovën dhe qytetarët e saj, për rajonin dhe për të gjithë Këshillin e Evropës.

Kryeministri e falënderoi Fondacionin Bertelsmann për mikpritjen, kontributin dhe interesimin e tyre, duke veçuar politikanët që tashmë na mbështesin në Gjermani dhe Evropë.

Kryetari i Gjilanit: Zgjerimi i rrugës 'Hamdi Kurteshi', projekt i madh që po jetësohet

GJILAN, 25 PRILL - Po vazhdojnë punimet në njërin ndër projektet më të mëdha të komunës së Gjilanit në rrugën "Hamdi Kurteshi", me vlerë 2.4 milionë euro.

Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me drejtorin për Mbrojtje dhe Shpëtim, Bejtullah Osmanin, me

zyrtarë komunalë dhe atë të FSK-së, kanë inspektuar ecurinë e punimeve.

I pari i Gjilanit tha se panë nga afër vendosjen e rrethojës së hekurt në brendësi të kazermës së Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërsa po vazhdon pastrimi i Lumit Stanishorka si dhe përgatitja e ndërtimit

të kolektorit. "Zgjerimi i rrugës 'Hamdi Kurteshi', një mega projekt që po jetësohet", ka thënë Hyseni. Ky projekt ishte paraqitur më 22 janar të këtij viti në kuadër të projekteve me moton "7 javë - 7 projekte", ndërsa gurmeheli ishte vënë më 1 dhjetor të vitit 2023.



Haradinaj: Fadil Vata do të mbetet gjithmonë frymëzues për përkushtimin ndaj atdheut

SUHAREKË, 25 PRILL - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe të varri i heroit Fadil Vata me rastin e 34-vjetorit të vdekjes së tij. Duke vlerësuar lart kontributin për lirinë e Kosovës, Haradinaj ka thënë se Fadil Vata do të mbetet shembull frymëzues për përkushtimin ndaj atdheut. "Heroi i kombit Fadil Vata, intelektual dhe patrioti i pathyeshëm ishte shtyllë e

lëvizjes patriotike - mishërim i idealeve për fitore, frymëzim për kryengritjen që po vinte nga trimat e Ushtrisë Çlirimtare. Sot me bashkëpunëtorë, në Sallagrazhdë të Suharekës nderuam dhe kujtuam sakrificën e tij sublime për lirinë e atdheut. Fadil Vata do të mbetet gjithmonë një shembull frymëzues për përkushtimin ndaj atdheut. Lavdi e përjetshme!", ka thënë Haradinaj.



Lladrovci: Përkrahja jonë për investitorët është e qëndrueshme dhe maksimale

DRENAS, 25 PRILL - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka takuar investitorë të mundshëm nga Mbretëria e Bashkuar dhe Turqia. Ai ka thënë se përkrahja e komunës për investitorët është e qëndrueshme dhe maksimale

për aq sa lejon ligji. "Zhvillova takime të rëndësishme lidhur me bashkëpunimin dhe investimet në komunën e Drenasit, njëra kompani nga Mbretëria e Bashkuar, për komunën me ndriçimin smart, tjetra Feronikli, për energjinë e ripërtërishme.

Përkrahja jonë për investitorët është e qëndrueshme dhe maksimale për aq sa lejon ligji, duke pasur për qëllim tërheqjen e investimeve, me klimë miqësore për të gjithë të interesuarit që hapin vende të reja pune", ka bërë me dije pas takimit Lladrovci.

Komuna e Deçanit fiton të drejtën për shfrytëzimin e tokave në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

DEÇAN, 25 PRILL - Komuna e Deçanit ka fituar të drejtën për shfrytëzimin e tokave në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", ka njoftuar kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj. "Në bazë të Vendimit nr. 10663 për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për pronat e shpallura me interes publik në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e

Nemuna", miratuar nga Kuvendi Komunal i Deçanit, datë 29.03.2024, pranuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe miratuar nga MAPL", ka shkruar Ramosaj

në "Facebook". Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në shkurt të këtij viti mori vendim për miratimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Sipas këtij vendimi, të gjithë personat fizikë dhe juridikë gjatë ushtrimit të aktiviteteve/veprimtarive në territorin e Parkut Kombëtar



"Bjeshkët e Nemuna" janë të obliguar t'i respektojnë dispozitat

e këtij plani si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Rama takon drejtoreshën e NDI-së, e falënderon për ndihmën dhënë kryeqytetit

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, bashkë me nënkryetarin Alban Zogaj, të enjten kanë takuar drejtoreshën e

Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), Nancy Soderberg, me të cilën kanë biseduar për anëtarësimin e kryeqytetit në Partneritetin

për Qeverisje të Hapur (OGP), e cila ndodhi më 16 prill 2024. Kryetari Rama e falënderoi ambasadorën Soderberg për ndihmën e ofruar në mënyrë

që kryeqyteti të avancojë në transparencë, llogaridhënie dhe ta rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal.



Kurti takim me mërgatën në Gjermani: Regjistrohuni, votoni dhe investoni në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryeministri Albin Kurti po qëndron për vizitë në Gjermani. Ai mori pjesë në panairin "Hannover Messe 2024". Në kuadër të kësaj vizite, Kurti së bashku me ambasadorin e Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti, kanë takuar pjesëtarë të mërgatës atje, me të cilët kanë biseduar për përfshirjen e tyre në shoqërinë e Kosovës, pjesëmarrjen në regjistrimin e popullsisë, zgjedhjet evropiane në qershor të këtij viti dhe tema të tjera me interes.

Sipas njoftimit për medie, thuhet se Kurti i njoftoi ata për zhvillimet e fundit në vend dhe për rezultatet e qeverisjes tash më shumë se tri vjet, me politikat sociale dhe zhvillimore të qeverisë, përfshirë ato të punësimit të rinjve dhe ndërlidhjes së arsimit me tregun e punës frymëzuar nga modelet e arsimit dual që i gjejmë pikërisht në Gjermani, Zvicër dhe Austri. "Duke marrë parasysh progresin që vendi ka shënuar në indikatorët demokratikë dhe ekonomikë dhe duke marrë shkas pjesëmarrjen në panairin 'Hannover Messe 2024', kryeministri ftoi dhe inkurajoi mërgatën të investojë në Kosovë. Atyre që kanë biznese në Gjermani u bëri thirrje të hapin degë në Kosovë", thuhet në



njoftim.

Tutje në njoftim theksohet se në kohën kur po zhvillohet procesi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, kryeministri përfitoi nga rasti për t'ua rikujtuar dhe për ta ftuar mërgatën të regjistrohet nëpërmjet

platformës online ediaspora.rks-gov.net deri më 17 maj. Ai theksoi se ky proces na mundëson të dimë se sa e kemi diasporën dhe është përcaktues për politikën zhvillimore të dekadës së ardhshme. "Ndërkaq sa iu përket zgjedhjeve evropiane të 9 qershorit, kryeministri i porositi

të gjithë ata që janë qytetarë të shteteve të Bashkimit Evropian, ta ushtrojnë të drejtën e tyre për votë dhe të jenë pjesëmarrës në proceset demokratike të vendeve të tyre dhe të kontinentit evropian.

Kryeministri Kurti i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për

mikpritjen e ngrohtë në Hanover, për interesimin e tyre aktiv për zhvillimet në vendin e tyre dhe për kontributin e vazhdueshëm dhe punën e madhe që gjithsecili pjesëtar i mërgatës e ka bërë dhe vazhdon ta bëjë ndër vite, pa ndërprerë, për Kosovën", thuhet në fund të njoftimit për medie.

UP-ja nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "Karamanoglu Mehmetbey"



PRISHTINË, 25 PRILL - Universiteti i Prishtinës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "Karamanoglu Mehmetbey".

Marrëveshja është nënshkruar nga rektori i UP-së, prof. Qerim Qerimi, dhe rektori i universitetit "Karamanoglu Mehmetbey", prof. dr. Mehmet Gavgal.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe prorektorja për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, prof. Arta Basha-Jakupi, dr. Lumniye Bajrami, drejtoreshë në ZMJ/Erasmus+, Afërdita Rexhepi, zyrtare për bashkëpunim ndërkombëtar/Erasmus+, si dhe profesori i asociuar Nezahat Ekici Ozcan KMU, lektor Ugur Aygun KMU, asistent profesor Ali Ozcan

KMU.

Marrëveshja synon ta lehtësojë bashkëpunimin akademik në fusha të ndryshme studimi, duke nxitur projekte të përbashkëta kërkimore, shkëmbime të stafit dhe të studentëve, promovim të mirëkuptimit kulturor dhe shkëmbim të njohurive, si dhe bashkëpunim në një periudhë prej pesë vjetësh.

Rektori Qerimi e vlerësoi arritjen e kësaj marrëveshjeje, e cila, sipas tij, do t'u shërbejë interesave të dy universiteteve.

Po kjo marrëveshje është një hap i rëndësishëm për avancimin akademik, njëherësh do të shërbejë edhe si një bazë për zhvillimin e marrëdhënieve afatgjatë ndërmjet dy universiteteve.

Zgjatet orari për ofrimin e shërbimeve për dokumente personale

PRISHTINË, 25 PRILL - Agjencia e Regjistrimit Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka marrë vendim që të gjitha qendrat për pajisje me dokumente të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 18:00 si

dhe të shtunave deri në orën 16:00. Edhe Drejtoria për Prodhim të Dokumenteve gjatë ditëve të punës do të punojë me dy ndërrime, kurse të shtunave deri në orën 16:00. Ky vendim është marrë në

mënyrë që t'u lehtësohet qytetarëve planifikimi i kohës dhe të shkurtohen pritjet për pajisje me dokumente personale. Vendimi për zgjatjen e orarit do të zgjasë deri te në një vendim tjetër.



Ministri Murati paraqet dy marrëveshje ndërkombëtare para Komisionit për Buxhet

PRISHTINË, 25 PRILL - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, kryesuar nga Armend Muja, kryetar, ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën fillimisht ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj, të cilin e ka paraqitur ministri i Financave, Hekuran Murati.

Ministri Murati tha se ky projekt ka vlerë prej 20 milionë eurosh dhe se qëllimi i tij është financimi i një impianti të ri të ujërave të zeza në Ferizaj, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe financimi i asistencës teknike përkatëse.

Po ashtu, ministri Murati paraqiti edhe projektin e marrëveshjes së nënshkruar me Bankën Evropiane të Këshillit të Evropës (BZhKE), ku si objektivi kryesor i këtij projekti është zhvillimi i sistemit të menaxhimit të banimit social në Kosovë. "Marrëveshja ka vlerën totale prej 25 milionë eurosh dhe do t'i mundësojë qeverisë ta zhvillojë sistemin e pranimin social në vend, ta rrisë numrin e popullatës në banimin social dhe përmirësoi



kushtet e jetesës për familjet me të ardhura të vogla", tha Murati gjatë prezantimit.

Anëtarët e komisionit shtruan pyetje lidhur me këtë marrëveshje dhe pas diskutimeve u pajtuan që në lidhje me këtë projekt, në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ndërsa Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj, nuk u

vtua në mungesë të kuorumit.

Në mungesë të vendimmarrjes nuk u votua as raporti me amendamente i Komisionit për Mjedis, Ushqim Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin për performancën energjetike të ndërtesave dhe as raporti me amendamente i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport për Projektligjin për Tekste Shkollore.

Mbledhja vijoi me shqyrtimin e raportit vjetor financiar të Zyrës

Kombëtare të Auditimit për vitin 2022 dhe 2023, të cilin e paraqiti auditorja e përgjithshme Vlora Spanca, votimi për të cilën u shty për mbledhjen e radhës.

Në këtë mbledhje raportin vjetor financiar të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022 dhe 2023 e paraqiti komisionerja Krenare Sogojeva-Dërmaku, ndërsa u shqyrtua edhe raporti vjetor financiar i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022 dhe 2023, paraqitur nga drejtori Yll Buleshkaj.

Komisioni vazhdoi mbledhjen me shqyrtimin e raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil për vitin 2022 dhe 2023, të cilin e paraqiti kryetari Arben Mehmeti.

Për këto tri raporte pati diskutime nga anëtarët e komisionit, ndërsa votimi i tyre u shty për një mbledhje tjetër.

Për mbledhjen e radhës, po ashtu, u shty edhe shqyrtimi i Komizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2025-2027.

10 mijë vizitorë vizituan Panairin Ndërkombëtar të Turizmit në Prishtinë



PRISHTINË, 25 PRILL - Edicioni i 20 i Panairit Ndërkombëtar të Turizmit dhe Sportit u përmbyll me një sukses të jashtëzakonshëm dhe interesim të madh, vizituar nga më shumë se 10 000 persona.

Teksa hapi dyert për vizitorë më 16-17 prill, në Sallën 1 Tetori në Prishtinë, panairi për dy ditë radhazi shërbeu si një platformë për ta shfaqur trashëgiminë e pasur kulturore dhe historike, peizazhet e ndryshme dhe përvojat emocionuese sportive të Kosovës dhe më gjerë. Nga turizmi kulturor dhe historik deri te sportet aventurose, panairi ofroi një eksplorim gjithëpërfshirës të të gjitha aspekteve të turizmit dhe sportit.

Pjesëmarrës të këtij panairi ishin federata të ndryshme të sportit, komuna nga Kosova dhe Shqipëria si dhe biznese turistike nga rajoni. Si ngjarja më e madhe në Kosovë, panairi shërbeu si një platformë vendimtare për bashkimin e edukatorëve, institucioneve dhe profesionistëve nga sektorë të ndryshëm për të shkëmbyer njohuri dhe ekspertizë. Kjo ngjarje luajti një rol kyç në lehtësimin e mundësive të rrjetëzimit, nxitjen e bashkëpunimit dhe promovimin e zhvillimit profesional.

Edhe Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik të komunës së Prizrenit mori pjesë duke promovuar potencialin turistik të

Prizrenit, që ishte një mundësi e mirë për prezantimin e ofertave e atraksioneve të qytetit të Prizrenit për profesionistët e industrisë së turizmit dhe sportit që, gjithashtu, nxit bashkëpunimin për investime të mundshme në këto fusha.

Për të pranishmit u paraqitën edhe vlerat e Elbasanit nga pasuritë natyrore deri te ato kulturore dhe historike, një mozaik multikulturor, me turizëm të qëndrueshëm që zgjat gjithë vitin. Edhe komuna e Gjakovës ka marrë pjesë në Panairin e Turizmit dhe Sportit 2024, ku përmes materialeve promovuese ka paraqitur trashëgiminë kulturore, atraksionet turistike si dhe investimet e ndryshme.

Të hyra mbi 500 milionë euro, Dogana shënon rekord të ri

PRISHTINË 25 PRILL - Dogana e Kosovës ka njoftuar se dita e enjte është përmbyllur me mbledhjen e të hyrave që tejkalojnë 500 milionë euro. "Kjo arritje paraqet një rritje të madhe prej 78 milionë eurosh, ose mbi 18 % krahasuar me mbledhjen e të hyrave të vitit të kaluar, duke tejkaluar dukshëm edhe projeksionin prej 6 % për këtë vit fiskal. Këto të hyra janë mbledhur edhe pse efekti në lirimet e taksave sipas vendimeve të qeverisë për importin për prodhuesit dhe

thellimi i lirimeve nga marrëveshjet e tregtisë së lirë janë thelluar dukshëm. Në këtë periudhë janë liruar 79 milionë euro taksë të kësaj kategorie apo 21 milionë më shumë se viti paraprak", ka njoftuar Dogana.

Sipas njoftimit, ngjashëm, bazuar në vendimin e qeverisë, është bërë progres i rëndësishëm në lehtësimin e tregtisë, veçanërisht me funksionimin efikas të zhdoganimit në portin e Durrësit dhe terminaleve të operuara nga shteti. "Ky


progres ka rezultuar në një kursim të konsiderueshëm të kostos prej 4.3 milionë eurosh gjatë periudhës tremujore, ndërsa që sipas trendit të progresit, ne parashikojmë që ky kursim të përshkallëzohet, duke arritur deri në 20 milionë euro deri në fund të vitit, duke optimizuar më tej proceset tona tregtare dhe duke përmirësuar rritjen ekonomike, njëkohësisht duke ndikuar në uljen e çmimit të konsumatori. Dogana e Kosovës mbetet e përkushtuar për të nxitur një



mjedis të favorshëm për eksportin, tregtinë dhe gjenerimin e të ardhurave, duke kontribuar në

prosperitetin dhe zhvillimin e Republikës së Kosovës", është theksuar në njoftimin për medie.

Dhjetë vjet vetmi: Bota letrare, një dekadë pa Marquezin



Nga: Livia IANNOTTA

Akoma edhe sot, dhjetë vjet pas vdekjes së shkrimtarit Gabriel García Márquez, laureat i Çmimit Nobel për Letërsinë në 1982, veprat e tij, klasike të përjetshme, vazhdojnë të na kujtojnë se Karaibet, Kolumbia, dhe në njëfarë mënyre e gjithë bota jonë, janë korniza magjike që përtej sipërfaqes bartin dimensione të tjera, jo më pak të jashtëzakonshme, që pa shkrimtarët si Márquezi rrezikojnë të mbeten të fshehura. Kur mendoj për Gabriel García Márquezin, më vjen në mendje muzgu i një oborri. Një nga ato oborret e brendshme të rrethuar nga ndërtesa me aromë koloniale, i zbukuar me hamak, ndenjese kashte, pemë dhe shtretër lulesh, ku mund të gjesh kollaj shpëtim nga vapa mbytëse e Karaibeve.

Kjo bashkëjetesë e diellit dhe e hijes te Gabo, ekziston me të vërtetë te ai dhe mund të shihet në mënyrën e tij të krijimit; në historitë që kanë ushqyer imagjinatën e brezave të Amerikës Latine dhe më pas të të gjithë botës. Duket sikur në atmosferën tipike tropikale të

librave të tij fshiheshin demonët e lashtë dhe vetë melankolia.

Pra, nëse pyes veten për arsyen pse Márquezi është në krye të shkrimtarëve të mi të zemrës, përgjigjem se ka të bëjë, por vetëm pjesërisht, me bukurinë e fletës: ajo gjuhë e harlisur ku mu rrit dëshira për intimitet mes meje dhe fjalëve. Dhe, pastaj, sigurisht ka të bëjë me imazhet: Rebeka duke mbërritur në Buendía me eshtrat e prindërve të saj në një thes; aroma e bajameve të hidhura; koloneli që ka pesëmbëdhjetë vjet që pret pensionin në postë çdo mëngjes; Sierva Maria e kafshuar nga një qen i tërbuar; një dashuri e paprekur që mbijetoi “pesëdhjetë e një vjet, nëntë muaj e katër ditë”.

Megjithatë, dy arsyeve të para duhet t’u shtoj edhe një të tretë, të lidhur me muzgun për të cilën po flisja: është një shtresë e hollë hidhërimi që mbështjell vendet; parandjenja gjatë përditshmërisë se fundi po afron, vetmitë e njerëzve, pamundësia që të lidhesh me të tjerët.

“Besoj se e gjithë jeta dhe letërsia ime kanë shërbyer për t’iu përgjigjur një pyetjeje të vetme: çfarë është vetmia? (...) E vërteta

është se nëse do të mund ta deshifroja, ndoshta nuk do të shkruaja më”.

Ndoshta për këtë arsye shkrimet e tija janë magjepsëse. Të lidhura ngushtë me të kaluarën, me komplotet e vendeve mitike, me gjenealogjitë që në çaste kyçe të kohës tregojnë ritet dhe folklorin e një populli. Ruajtja e kujtesës është qëllimi pas çdo rreshti të romaneve të tij. Aq sa në autobiografinë e vet Jeto për ta treguar ai shkon aq larg sa thotë se “Jeta nuk është ajo që ke jetuar, është ajo që të kujtohet dhe ashtu siç të kujtohet për ta rrëfyer.”

Në këtë mënyrë Arakataka, një qytet në Kolumbinë Atlantike ku Márquezi lindi më 6 mars 1927, i pari nga gjashtëmbëdhjetë fëmijët e telegrafistit Gabriel Eligio García dhe largpamëses Luisa Márquez Iguarán, përfundon duke u rishfaqur në Makondo, fshati që nuk ekziston, sfondi i Njëqind vjet vetmi dhe që më pas, duke dalë nga imagjinata, bëhet territor i shpirtit, gjeografi fantastike e njeriut, një qytet-botë.

Kështu, dita në të cilën gjyshi i tij, koloneli liberal Nicolás Ricardo Márquez Mejía, e shoqëron atë në fabrikën e një kompanie

shumëkombëshe për të mësuar rreth akullit, jehon në fillimin e paharrueshëm të Njëqind vjet vetmi.

Dhe mbi të gjitha, historitë, besimet, besëtytnitë me të cilat gjyshja Tranquilina – gjithmonë e veshur në zi dhe në kontakt të pandërprerë me të vdekurit – rrëfente fëmijërinë e saj, dalin nga streha e kujtesës për të banuar ndër faqet e librave më të dashur: nga Dashuria në kohërat e kolerës te Vjeshta e patriarkut, nga Gjethurinat te Për dashurinë dhe demonë të tjerë, nga Kujtim kurvash të trishta, deri te Shihemi në gusht.

Fituesi i çmimit Nobel për letërsinë në vitin 1982, Márquezi na kujtoi se Karaibet, Kolumbia dhe në një farë mënyre e gjithë bota janë plot magji; se përtej sipërfaqes së gjërave ka edhe të tjera, jo më pak të jashtëzakonshme, që kanë mbetur të fshehura.

Për të, të shkruarit ishte edhe një akt politik. Në vitin 1973, kur demokracia kiliane u shtyp nga grushti i shtetit i Pinochet-it, ai deklaroi se nuk do të shkruante më derisa të binte diktatura. Pinochet-i e mbajti pushtetin për njëzet vjet. Márquez, për fat të mirë, iu kthye shkrimit shumë

më herët. Në një intervistë në vitin 1987 ai rrëfeu:

Jeta e një shkrimtari është po ashtu e mbushur me beteja të humbura; unë e humba timen. Arrita në përfundimin se do të bëja më shumë kundër Pinochet-it duke shkruar libra të mirë sesa duke mos i shkruar. Ia kisha nënshtruar veten, pa e kuptuar, censurës së tij parandaluese që më la në heshtje për gati pesë vjet. Edhe pse, në fund të fundit, ideologjia e tij e vërtetë mbetej dashuria, e perceptuar si një ndjenjë përbashkuese, që prek gjithçka, përmbys gjithçka dhe, po, revolucionarizon gjithçka.

Dhjetë vjet më parë, në Meksiko-Siti, në shtëpinë ku ai jetonte me të shoqen Mercedes, që e imagjinoj si të ishte ndërtuar përreth një prej atyre oborreve të qeta që përmenda që në krye, vdiq Gabriel García Márquez. Në të njëjtën intervistë të vitit 1987, kur gazetari e pyet nëse ka frikë nga vdekja, Márquez përgjigjet: “Nga vdekja jo, nga të vdekurit po. Më shqetëson, si shkrimtar, që ngjarja më e rëndësishme në jetën time, vdekja, është e vetmja për të cilën nuk do të mund të shkruaj kurrë.” Çfarë magjie e pabesueshme do të ishte të lexoje për të. /Gazeta “ExLibris”/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Gjokaj do t'i nënshtrohet operimit

PRISHTINË, 25 PRILL - Portieri i Prishtinës, Altin Gjokaj, është lënduar sërish dhe do t'i nënshtrohet një operimi. Lajmin e ka konfirmuar klubi kryeqytetas në faqen

zyrtare në "Facebook". "Shërim të shpejtë, Gjoka. Portieri ynë i ri, Altin Gjokaj, pas pësimit të një lëndimi gjatë seanceve stërvitore, është i detyruar

t'i nënshtrohet operimit të miniskusit, operim ky që do ta lë për një kohë jashtë fushave, por Gjokaj do të rikthehet edhe më i fortë", thuhet në njoftimin e FC

Prishtina. Skuadra "bardhekaltër" të mërkurën e ka siguruar kualifikimin në finale të Kupës ku përballë do ta ketë skuadrën e Ballkanit.



Katër klube ndjekin Kupën në hendboll

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 PRILL - Turneu final i Kupës së Kosovës në hendboll do të zhvillohet të shtunën dhe të dielën në Pejë. KHF Istogu është fitues në fuqi, ndërsa në gjysmëfinale përballët me Vushtrinë. Para kësaj përballje ka folur kapitenia e kësaj skuadre dhe një prej lojtarëve më të mira, Albina Rugova. Ajo ka deklaruar se synon që me skuadrën e Istogut ta fitojë Kupën për edicionin 2023/2024. "Final 4 gjithmonë sjellë atmosferë të veçantë. Të gjitha skuadrat synojnë trofeun e Kupës së Kosovës. Dihet që Istogu gjithmonë lufton për trofe. Kemi

tejkualuar disa probleme të vogla me lëndime. Atmosfera në skuadrë është shumë e mirë. Me përkrahjen edhe të publikut istogas synojmë trofeun e gjashtë me radhë të Kupës së Kosovës. Të gjitha skuadrat pretendente kanë lojtare cilësore. Na presin ndeshje të vështira e gjithësi cilësore. Istogu në Pejë luan si në shtëpi të vet dhe kjo pres të jetë përparësi për ne", ka thënë Rugova. Për turneun e Kupës foli edhe kapitenia e Vushtrisë, Burneta Rama, e cila tha se janë të lumtura që në fundjavë do të paraqiten në turneun final të Kupës së Republikës së Kosovës. "Sigurisht se ne si ekip jemi të lumtur që kemi arritur të jemi në mesin e katër



ekipeve më të mira. Kemi punuar shumë dhe jemi më se të motivuara dhe të gatshme për lojë. Synimet tona janë të kemi paraqitje të mirë, të bëjmë lojë korrekte. Nuk dorëzohemi asnjëherë. Në fakt, edhe njihemi si ekip që nuk dorëzohet deri në momentin e fundi. Pavarësisht se jemi ekip me lojtare prej më të rejave, do të angazhohemi deri në fund. Mendoj se ndeshje si këto të turneut final të kupës u ndihmojnë

lojtareve të ndërtohen dhe sigurisht të përgatiten për të ardhmen e tyre", ka thënë Rama. Skuadra e Ferizajt vlerësohet një prej precedentëve për ta fituar Kupën, derisa në gjysmëfinale kjo skuadrë përballët me Samadrexhën. Kapitenia e Ferizajt, Aida Stagova, është optimiste se skuadra ferizajase do të dalë e suksesshme. "Ekipin ynë është duke punuar intensivisht që nga janari. Kemi synime të qarta. Jemi të bashkuara dhe të motivuara që ky vit të jetë shumë i suksesshëm për ne. Jemi të gatshme ta kalojmë gjysmëfinalen dhe me sukses në finale t'i përmbylim qëllimet tona. Duam që Kupa të na shoqërojë rugës për në Ferizaj", ka thënë

Stagova. Ndërsa skuadra e Samadrexhës që ka formuar skuadrë pretendente gjithë fokusin e ka te turneu final i Kupës. Kapitenia Jihen Ben Hrouz ka thënë se Samadrexha është e përgatitur si duhet dhe se do të ketë një prezantim ashtu siç duhet. "Final 4 do të jetë një ngjarje e jashtëzakonshme për tifozët e hendbollit në Kosovë. Katër ekipet e kualifikuara kanë dëshmuar se janë ekipet më të mira këtë stinor. Ne do t'i mbrojmë ngjyrat e ekipit tonë, KHF Samadrexha, deri në fund. Jemi përgatitur si duhet dhe shpresojmë të prezantojmë nivel të mirë të hendbollit për tifozët në Pejë. Dhe në fund le të fitojë më i miri", ka thënë Ben Hrouz.

Distria Krasniqi, kampione e Evropës

PRISHTINË, 25 PRILL - Distria Krasniqi është shpallur kampione e Evropës në xhudo në kategorinë deri në 52 kilogramë, të Kampionatit Evropian të xhudos, i cili po mbahet në Zagreb të Kroacisë. Kampionia olimpikë në finale mposhti xhudisten italiane, Odette Giuffrida me waza-ari. Krasniqi pati performancë fantastike, duke i

fituar një nga një përballjet e saja. Xhudistja pejane në gjysmëfinale e mposhti spanjollen Ariane Toro Soler për ta siguruar së paku medaljen e argjendtë, por që do ta kërkojë edhe të artën në finale gjithësi. Paraprakisht, xhudistja pejane e eliminoi kroaten Ana Viktorija në çerekfinale për t'u plasuar në mesin e katër më të

mirave evropiane në kategorinë deri në 52 kilogramë. "Disi" e kaloi rrethin e parë pa luftë, kurse në atë të dytën e mposhti ukrainasen Anna Borodina. Ndërkohë, garuesja tjetër kosovare, Flaka Loxha u eliminua qysh në rrethin e dytë, pasi të parin e kaloi pa luftë, pasi u mposht nga kroata Tihea Topolovec.



Mutu: Rrahmani është sulmuesi më i mirë në Rumani

BUKURESHI, 25 PRILL - Albion Rrahmani i ka mahnitur të gjithë me kualitetet e tij. Sulmuesi kosovar ka filluar të lërë gjurmë menjëherë në futbollin rumun, ndërsa i ka shënuar 17 gola në këtë edicion me Rapid Bukureshtin. E lënduar për ish-futbollistin e Malishevës dhe të Ballkanit nuk kanë të ndalur. Atë



e ka lavdëruar së fundmi edhe legjenda rumune Adrian Mutu, i cili mendon se nuk ka

qendërsulmues si përfaqësuesi kosovar në ligën ku luan ai. 23-vjeçari i ka shënuar 17 gola në 21 ndeshje të këtij edicioni, përfshirë këtu 13 në sezonin e rregullt dhe 4 në "play-off". "Mendoj se është një sulmues shumë i mirë. Mendoj se është '9-shi' më i mirë në kampionatin tonë. Largimi më pak varet nga

ai, por nga planet që Rapidi i ka bërë për të ardhmen. Në sezonin e kaluar Rapidi e pati një sulmues si Dugandziç, e tash e ka Rrahmanin dhe mendoj se do të ishte mirë ta mbajë", u shpreh ish-futbollisti i Juventusit dhe Interit për mediumin rumun "Digisport". Ofertat për Rrahmanin nuk po mungojnë

dhe ai mund të transferohet në një ligë më të fortë evropiane nëse vazhdon formën e mirë. Interesim për të kanë shfaqur Benfica në Portugali dhe Werder Bremen në Gjermani. Sipas Mutu, Rapidi me lojtarë si Rrahmani mund ta fitojë titullin e kampionit në edicionin e ardhshëm.

FC Prishtina 01, fituese e Kupës në futsall

PRISHTINË, 25 PRILL - FC Prishtina 01 është fituese e Kupës së Kosovës në futsall për herë të tretë. Në një finale emocionuese, e cila u zhvillua në Pallatin e Rinisë dhe Sportit, skuadra kryeqytetase arriti të fitojë ndaj skuadrës nga

Drenasi, Liqeni, pas një sfide mjaft rivalizuese dhe interesante, me rezultat 3:2, pas vazhdimëve, ngase ndeshja në kohën e rregullt u mbyll baras, 2:2. Prishtina 01 e nisi ndeshjen në mënyrë më të mirë, duke kaluar në epërsi me golin e Arif

Limanit. Megjithatë, skuadra nga Drenasi tregoi karakter dhe përkushtim duke e barazuar shpejt rezultatit me gol të Dardan Topillës nga penalltia. Prishtinasit rikthyen epërsinë me golin e Fitim Krasniqit, por përsëri ishte Liqeni që vendosi

baraspeshën me një gol të Camilo Sanchez. Kur të gjithë menduan se fituesin e kësaj finaleje do ta përcaktonin penalltitë, në 10 sekondat e fundit pas një këndore më së miri afër portës u gjend Yll Mazreku, i cili shënoi golin e



fitores për Prishtinën 01, duke bërë që trofeu të mbetet përsëri në kryeqytet.

Greza me vendim të papritur: Do të pushoj nga futbolla

TIRANË, 25 PRILL - Eros Greza e ka marrë një vendim të papritur. Futbollisti nga Kosova ka marrë pauzë nga futbolla. Përfaqësuesi shqiptar, i cili në afatin kalimtar të janarit kaloi në Kroaci te Rudes, pas një përvojë në Shqipëri

me Partizanin, në rrjetet sociale njoftoi se i duhet të pushojë dhe për momentin të ndahet nga futbolla. 29-vjeçari ka vuajtur shumë në këtë periudhë të fundit teksa problemet fizike nuk e kanë lejuar ta shprehë maksimumin në fushë,

ashtu siç ishin mësuar të gjithë në fillimet e karrierës së gjakovarit. "Faleminderit Rudesit për mundësinë dhe mirëkuptimin. Kam marrë një vendim që për momentin të pushoj nga futbolla", ka shkruar Greza. Megjithatë, kjo

periudhë reflektimi mund t'i shërbejë Grezës për t'u rikthyer në më të mirën e tij. Eros Greza në karrierën e tij numëron edhe 13 paraqitje me fanellën e kombëtares kuqezi teksa ka realizuar edhe një gol me kuqezinjtë.



Xavi konfirmon qëndrimin te Barça: Lojtarët ishin vendimtarë në zgjedhjen time

BARCELONË, 25 PRILL - Xavi Hernandez mbetet te Barcelona dhe tani kjo është zyrtare. Pas takimit të së mërkurës në mbledhje me presidentin Laporta, të dy e konfirmuan publikisht lajmin në një konferencë për shtyp. "Lojtarët ishin vendimtarë në zgjedhjen time. Më bënë të kuptoj se po punojmë mirë dhe së shpejti do të mund të fitojmë sërish. Unë jam një tifoz i madh i këtij klubi", ishin fjalët e Xavit, i cili në fund të janarit deklaroi që do të largohej, por tashmë ndërroi mendje. Edhe Laporta foli i lumtur për këtë vendim të Xavit,



ku së bashku do ta vijojnë projektin e tyre të klubit. "Ai më përcolli entuziazmin e tij për projektin tonë. Ne do të bëjmë disa ndryshime, por ne kemi nevojë për stabilitet dhe fakti që

Xavi vazhdon të jetë trajner i ekipit është një lajm i mirë në këtë kuptim. Ne besojmë në këtë projekt, Xavi është shumë i dashur në klub", u shpreh presidenti i Barçës. Xavi flet sërish gjatë konferencës dhe këtë herë falënderon tifozët. "Kam një ndjenjë të shkëlqyer me ta. Ishin një nga pikat vendimtare për qëndrimin tim. I falënderoj për mbështetjen që më dhanë. Tani do të duhet të korrigjohem disa detaje dhe do të kthehem në luftë për të fituar. Pashë që skuadra beson tek unë dhe ndihem më i fortë", ka përfunduar Xavi.

SHKURT

Trajneri i Rubin Kazanit lavdëron Dakun

Rubin Kazani arriti fitore të rëndësishme 2-0 në San Petersburg përballë Zenitit, i cili e kryeson ligën elitare ruse. Dhe, protagonist i ekipit nga Kazani ishte sulmuesi kosovar Mirlind Daku, i cili e shënoi golin e parë dhe asistoi në atë të dytë. Reprzentuesin shqiptar e ka lavdëruar trajneri i Rubin Kazanit, Rashid Rakhimov, i cili e vlerësoi lart paraqitjen e ish-futbollistit të Dritës, Llapit e Ballkanit, i cili e kishte një përvojë edhe në Kroaci para se të transferohej në Rusi. "E shihni vetë se si është Daku. Nuk dua ta lavdëroj, por sot ishte me të vërtetë një ndeshje shumë e mirë. E lavdërova tani dhe ai thotë: 'Faleminderit Zot, të paktën një herë më ke thënë fjalë të mira'. I thashë se nesër do të dëgjonte diçka ndryshe", ka thënë Rakhimov. Daku i ka shënuar 6 gola dhe i ka bërë 4 asistime në këtë sezon me fanellën e Rubin Kazanit.

Kloppi pas humbjes nga Evertoni: U kërkoj falje tifozëve

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka kërkuar falje pas humbjes ndaj Evertonit të mërkurën mbrëma me rezultat 2-0. Kjo humbje ka zbehur shumë gjasat e Liverpoolit për titull, pasi kanë mbetur vetëm edhe katër ndeshje deri në mbylljen e sezonit. Pas kësaj disfatë, Liverpooli është i dyti në tabelë, tri pikë pas Arsenalit që ka një golavarazh superior, ndërsa Manchester City është një pikë prapa 'Reds', por ka dy ndeshje më pak. "Arsenali dhe Manchester City duhet të kenë një moment shumë të keq", ka thënë Klopp për "Sky Sports" kur u pyet nëse Liverpooli është ende në garën për titull. "Nuk e di. Për sot mund t'u kërkoj falje njerëzve. Duhet të kishim bërë më mirë, por nuk e bëmë", ka thënë trajneri gjerman.

City, gati 200 milionë euro për transferimet e verës

Pep Guardiola do të ketë në dispozicion 200 milionë euro për të shpenzuar në merkaton e verës. Drejtuesit e Manchester Cityt kanë vendosur t'i dhurojnë këtë shumë teknikut spanjoll për të krijuar një skuadër të frikshme. Objektivi i parë është Lucas Paqueta i West Hamit, të cilin e kërkoj edhe në fundin e verës së kaluar. Në listën e trajnerit katalanas ndodhen edhe emra si Jamal Musiala (Bayern Munchen) dhe Bruno Guimaraes (Newcastle). Por edhe Joao Neves, 19-vjeçari i talentuar i portugezëve të Benficës, i cili luan në rolin e mesfushorit përpara mbrojtjes. Neves debutoi edhe me Kombëtaren e Portugalisë gjatë tetorit të vitit të kaluar.

Formula 1 në kërkim të pistave të reja, Azia hedh kandidaturën me dy gara spektakolare

Me përfundimin e Çmimit të Madh të Kinës, Formula 1 largohet përkohësisht nga Azia për të kaluar në Amerikë, ku do të zhvillohet gara e radhës në Majemi. Gjithsesi, garat do të rikthehen në kontinentin aziatik në mes të shtatorit për Çmimin e Madh të Singaporit. Por këto tri gara, Japonia, Kina e Singapori, mund të mos jenë pistat e vetme të Azisë së Largët ku zhvillohet Formula 1. Koreja e Jugut ka aplikuar për të organizuar sërish një fundjavë gare, por jo më në pistën e Yeongam, ku u zhvilluan 4 gara, nga viti 2010 deri në vitin 2013. Në këtë rast, vendi tjetër i mundshëm mund të jetë qarku i rrugës Incheon, i vendosur disa kilometra larg kryeqytetit Seul.

Presidenti dhe CEO i F1, Stefano Domenicali, kishte deklaruar se do të udhëtonte në Kore, por ditari i tij i udhëtimit në Azi mund të përfshijë edhe një vend tjetër. Formula 1, e cila ka përjetuar një zgjerim të fortë ndërkombëtar vitet e fundit, po shqyrton përfshirjen e kombeve të tjera nga viti 2026 e në vazhdim. Dhe vendi tjetër aziatik që kërkon një garë është Tajlanda. Në këtë rast, projekti do të ishte ai i një piste qytetase spektakolare.

Miami triumfon në fushën e Bostonit, Oklahoma fiton pa probleme ndaj New Orleansit

BOSTON, 25 PRILL - Dy ndeshje të luajtura në çerekfinalet e "play-off"-it në NBA, nga një për secilën Konferencë. Në Lindje, ekipi i Miamit fitoi me rezultat 111-101 në fushën e Bostonit, duke barazuar 1-1 serinë e takimeve. Të gjithë titullarët e ekipit nga Florida realizuan mbi 10 pikë, me Tyler Herro që ishte protagonist me 24 pikë e 11 asistime. Adebayo e Martin realizuan nga 21 pikë secili për Miamin. Për Bostonin, dyshja Brown - Tatum realizoi 61 pikë, por që mbetën për statistikë. Në Perëndim, skuadra e Oklahomas udhëheq 2-0 serinë



e ndeshjeve ndaj New Orleansit, pas fitores me shifrat 124-92. Ndeshje pa histori, komanduar nga vendasit, që u renditën të parët në sezonin e rregullt. Të gjithë titullarët realizuan mbi 15 pikë, me Alexander Shai

protagonist, autor i 33 pikëve, mbështetur nga Holmgren me 26 pikë. Për miqtë mungoi lojtari lider.

ÇERKFINALET - KONFERENCA E LINDJES

CLEVELAND - ORLANDO	(2-0)
NEW YORK - PHILADELPHIA	(2-0)
BOSTON - MIAMI	101-111 (1-0)
MILWAUKEE - INDIANA	(1-1)

ÇERKFINALET - KONFERENCA E PERËNDIMIT

MINNESOTA - PHOENIX	(2-0)
DENVER - LAKERS	(2-0)
CLIPPERS - DALLAS	(1-1)
OKLAHOMA - NEW ORLEANS	124-92 (1-0)

Gjermania ashpëron masat për tifozët në 'Euro 2024'

BERLIN, 25 PRILL - Kampionati Evropian i kësaj vere paraqet sfida të mëdha për autoritetet gjermane të sigurisë. Miliona tifozë pritet të jenë pjesë e këtij turneu, që do të mbahet nga 14 qershori deri më 14 korrik, për t'i mbushur stadiumet dhe të marrin pjesë në festimet publike. Autoritetet gjermane parashikojnë 2.7 milionë tifozë në stadione dhe deri në 12 milionë tifozë në zonat "fan-club" në dhjetë qytetet pritëse. Sipas medie gjermane, vetëm Berlini pritet të presë 2.5 milionë vizitorë, me pritshmëri masive të tifozëve në zona të caktuara si ajo rreth Portës së Brandenburgut. Vizitorët e stadioneve do të përballen me kontroll të dyfishtë të sigurisë, me një kontroll të parë



jashtë dhe një të dytë brenda perimetrave të sigurisë, ku bileta dhe artikujt personal do të nënshtrohen në inspektim të detajuar. Kërcënimet që ato përballen janë të ndryshme dhe përfshijnë rrezikun nga terrorizmi,

huliganizmi, kriminaliteti i dhunshëm dhe sulmet kibernetike. E veçantë për Euro 2024 është edhe gjendja e sigurisë ndërkombëtare dhe tensionet gjeopolitike, si përshkallëzimi në Lindjen e Mesme dhe konflikti rus në Ukrainë, të cilat mund të kenë ndikim mbi turneun. Si mënyrë shtesë e mbrojtjes, kufijtë gjermanë do të monitorohen më repretishtë gjatë "Euro 2024", me kontrolle të rastësishme që mund të ndodhin. Gjermania ka një histori të vendosjes së kontrollit të përkohshëm kufitar për evente të mëdha sportive si Kupa e Botës 2006 dhe punon ngushtë me vendet pjesëmarrëse dhe fqinje për të siguruar një ambient sa më të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar Ligjor
Grada e pozitës:	gjashtë (6)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Ligjor dhe i Pajtueshmërisë
Divizioni:	Legjislacion dhe Rregullativë
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit për Legjislacion dhe Rregullativë

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësisë:

- Asiston në përmbushjen e detyrave të përgjithshme të departamentit/divizionit për legjislacion dhe rregullativë;
- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të departamentit/divizionit;
- Siguron që korniza ligjore e Bankës Qendrore është në pajtim me ligjet, rregulloret, rregullat dhe politikat e procedurat relevante si dhe me standardet më të mira ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Evropian;
- Merr pjesë në hartimin dhe përditësimin e kornizës ligjore të bankës qendrore;
- Ofron këshilla/opinione ligjore;
- Shqyrton draft aktet nënligjore, si dhe draft kontrata, marrëveshje dhe dokumente tjera ligjore me të cilat sigurohet administrim efektiv dhe efikas i bankës qendrore;
- Shqyrton çështjet ligjore dhe jep rekomandime profesionale për veprime të mëtejme ndërlidhur me to;
- Ndërmerr veprime ligjore brenda autorizimeve dhe përgjegjësisë të deleguara;
- Bashkëpunon ngushtë me departamentet dhe divizionet tjera të Bankës Qendrore në çështje ligjore me qëllim të sigurimit të konsistencës ligjore e rregullative si dhe pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi;
- Përpilon parashtrësia ligjore, sipas kërkesës dhe nevojave të parashtruara;
- Kujdeset për respektimin e të gjitha afateve ligjore në pajtim me kornizën ligjore në fuqi;
- Sipas autorizimit, merr pjesë në komisione dhe grupe përkatëse punuese brenda dhe jashtë Bankës Qendrore;
- Përgatitë raporte dhe evidenca lidhur me kryerjen e punëve brenda përgjegjësisë të deleguara;
- Kryen detyra të tjera të caktuara sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimi dhe dituritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë- Fakulteti Juridik;
- Njohuri të sistemit ligjor dhe ligjeve të Kosovës, veçanërisht atij të sistemit financiar, të punës, mbi procedurën administrative, kontestimore, përbarimore, marrëdhëniet e detyrimeve, etj;
- Njohja e legjislacionit të Bashkimit Evropian është përparësi;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Përvoja e kërkuar:

- Minimum 2 vite përvojë pune profesionale në fushën ligjore.

Kërkesat e posaçme:

- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe shkrim ligjor-(formulim të shkresave rekomandimeve dhe opinioneve ligjore);
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e çështjeve sipas prioriteteve;
- Vetinitivë dhe gatishmëri për punë ekipore;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimor (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **10 maj 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Pravni službenik
Stepen pozicije:	Šest (6)
Trajanje radnog odnosa:	Na neodređeni rok
Odeljenje:	Za pravo i usaglašenost
Odsek:	Za zakonodavstvo i propise
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za zakonodavstvo i propise

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u ispunjavanju opštih dužnosti odeljenja/odseka za zakonodavstvo i propise;
- Izrađuje planove rada u dogovoru sa rukovodiocem za realizaciju dužnosti utvrđenih na osnovu ciljeva odeljenja/odseka;
- Osigurava da je zakonski okvir Centralne banke u skladu sa relevantnim zakonima, propisima, pravilima i politikama i procedurama, kao i sa najboljim međunarodnim standardima i direktivama Evropske unije;
- Učestvuje u izradi i ažuriranju zakonskog okvira centralne banke;
- Pružava pravne savete/mišljenja;
- Razmatra nacрте podzakonskih akata, kao i nacрте ugovora, sporazuma i drugih zakonskih dokumenata koji obezbeđuju efektivnu i efikasnu administraciju centralne banke;
- Razmatra zakonska pitanja i daje stručne preporuke za dalje postupanje u vezi sa njima;
- Preduzima zakonske radnje u okviru delegiranih ovlašćenja i odgovornosti;
- Blisko saraduje sa drugim odeljenjima i odsecima Centralne banke u zakonskim pitanjima kako bi se osigurala zakonska i regulatorna konzistentnost, kao i usaglašenost sa zakonodavstvom na snazi;
- Sastavlja pravne podneske, prema zahtevu i iznesenim potrebama;
- Brine o poštovanju svih zakonskih rokova u skladu sa zakonskim okvirom na snazi;
- Po ovlašćenju učestvuje u nadležnim komisijama i radnim grupama unutar i van Centralne banke;
- Priprema izveštaje i evidencije u vezi sa obavljanjem poslova u okviru delegiranih nadležnosti;
- Obavlja i druge dodeljene poslove po zahevu nadzornika.

Potrebna kvalifikacija i znanja:

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava - Pravni fakultet;
- Poznavanje pravnog sistema i zakona Kosova, posebno o finansijskom sistemu, o radu, o upravnom, parničnom, izvršnom postupku, obligacionim odnosima itd.;
- Poznavanje zakonodavstva Evropske unije je prednost;
- Tečno govorenje i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno iskustvo:

- Minimalno 2 godine profesionalnog radnog iskustva u pravnoj oblasti.

Posebni zahtevi:

- Istraživačke, analitičke, ocenjivačke i pravne veštine pisanja (formulisanje pisama preporuke i pravnih mišljenja);
- Pažnja prema detaljima, jasan tekst i tačnost;
- Sposobnosti komunikacije u pisanju kao i sposobnost rešavanja pitanja prema prioritetima;
- Samoinicijativnost i spremnost za timski rad;

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Pratno pismo (motivaciono pismo) u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji služe za dokazivanje funkcije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj od Fonda penziona štednje Kosova (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Fonda nije zakonski primenjen;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **10 maj 2024**.
- Apliciranje se može obaviti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostale forme apliciranja se neće uzeti u razmatranje.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko službene internet stranice: www.bqk-kos.org.



RI-SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Ekonomist/e i/e ri/e për Stabilitet Financiar
Grada e pozitës:	shtatë (7)
Kohëzgjatja e punësimit:	pa afat
Pozita:	e përhershme
Departamenti:	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar
Divizioni:	Divizioni për Stabilitet Financiar
Raporton tek:	Udhëheqëses së Divizionit për Stabilitet Financiar

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Asiston në implementimin e programin afatshkurtër dhe afatmesëm të punës në fushën e stabilitetit financiar;
- Merr pjesë në përgatitjen e analizave të sektorit financiar me qëllim të arritjes së objektivave përkatëse dhe realizimit të detyrave përkatëse të BQK-së;
- Analizon dinamikat e tregjeve dhe institucioneve financiare, me qëllim të identifikimit të rreziqeve që përbëjnë kërcënime për stabilitetin e sistemit financiar;
- Kontribuon në vlerësimin e rrezikut sistematik, përmes analizimit dhe avancimit të vazhdueshëm të instrumenteve dhe modeleve për vlerësimin e këtij rreziku;
- Kontribuon në definimin e kërkesave për të dhënat e duhura në procesin e hulumtimit duke përfshirë mbledhjen, përpilimin dhe organizimin e të dhënave statistikore relevante për procesin e hulumtimeve;
- Rekomandon dhe kontribuon në çështje të ndryshme me relevancë për fushën e stabilitetit financiar dhe proceset e punës në departament;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante përkitazi me çështjet e stabilitetit financiar;
- Përbush detyra tjera në bazë të kërkesës së mbikëqyrësit.

Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë bachelor në fushën e ekonomisë, statistikës, matematikës, financës ose disiplina të ngjashme. Niveli pasuniversitar është i dëshirueshëm;
- Përvoja e punës në fushën e analizave të sistemit financiar dhe analizave makroekonomike në institucione financiare, institucione kërkimore apo subjekte tjera me karakter kërkimor është e dëshirueshme;
- Njohuritë dhe shkathtësitë në modelim të dëshirueshme;
- Rrjedhshmëri në gjuhën shqipe dhe njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Kërkesa të posaçme:

- Aftësi shumë të mira analitike, të shkruara dhe në të folur;
- Vet-iniciativë, aftësi të zgjidhjes së problemeve, bashkërendimit dhe punës në grup.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **10 maj 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org



PONOVNO OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Mlađi ekonomista za finansijsku stabilnost
Stepen pozicije:	sedam (7)
Trajanje zaposlenja:	bez roka
Pozicija:	stalna
Odeljenje:	Odeljenje za ekonomske analize i finansijsku stabilnost
Odsek:	Odsek za finansijsku stabilnost
Izveštava:	Rukovodiocu Odeljenja za finansijsku stabilnost

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u realizaciji kratkoročnog i srednjoročnog programa rada u oblasti finansijske stabilnosti;
- Učestvuje u pripremi analiza finansijskog sektora u cilju postizanja relevantnih ciljeva i izvršavanja relevantnih zadataka CBK-a;
- Analizira dinamiku finansijskih tržišta i institucija, kako bi se identifikovali rizici koji predstavljaju pretnju stabilnosti finansijskog sistema;
- Doprinosi proceni sistemskog rizika, kroz analizu i kontinuirano unapređenje instrumenata i modela za procenu ovog rizika;
- Doprinosi definisanju zahteva za odgovarajućim podacima u procesu istraživanja, uključujući prikupljanje, kompilaciju i organizaciju statističkih podataka relevantnih za proces istraživanja;
- Preporučuje i doprinosi različitim pitanjima od značaja za oblast finansijske stabilnosti i procesa rada u odeljenju;
- Podržati neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama u vezi sa pitanjima finansijske stabilnosti;
- Obavlja i druge poslove na zahtev supervizora.

Potrebna znanja:

- Diploma bachelor iz ekonomije, statistike, matematike, finansija ili sličnih disciplina. Postdiplomski nivo je poželjan;
- Poželjno radno iskustvo u oblasti analize finansijskog sistema i makroekonomske analize u finansijskim institucijama, istraživačkim institucijama ili drugim subjektima istraživačkog karaktera;
- Poželjna znanja i veštine modeliranja;
- Tečno poznavanje albanskog jezika i odlično poznavanje engleskog jezika.

Posebni zahtevi:

- Veoma dobre analitičke, pismene i govorne veštine;
- Samoinicijativnost, veštine rešavanja problema, koordinacije i timskog rada.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kojem je naglašeno interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **10 maj 2024**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali oblici za prijavu neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko službene internet stranice: www.bqk-kos.org

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arben Morina shpall të pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.
- Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- Enise Shuki shpall të pavlefshme dëftësat e kl I - VIII shfmu “ Motrat Qirazi “ Prizren.
- Lavdije Sopi shpall te pavlefshme dëftësat e kl I - VIII shfmu “ Zef Lush Marku “ Velezhe.
- Bejadin Dervishaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- Zylmi Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftësat dhe diplomën Q.K . “11 Marsi” Prizren.
- Jashar Krasniqi nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftësën e plot të shkollës fillore Kongresi i Manastirit Damjan KK Gjakovë.
- Edita Beqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Astrit Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.
- Xhavit Januzi nga Nivokazi KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. Bujqësi “ Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Alban Meta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftësën e plotë prej klasës 1-8 të shkollës fillore “Selman Riza”, Gjakovë.
- Fisnik Nixha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftësat e kl. 10.11. të sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë, Elektroteknik.
- Fatlinda Gjuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.
- Kingj Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “ Kadri Kusari” Gjakovë.
- Bekim Veljiji shpall te pavlefshme dëftësat e kl I - VIII shfmu “ Leke Dukagjini “ Prizren.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË





TRADITË QË NGA 1992

